

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Praktika e Auditimit të
Brendshëm**

B3

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 02.02.2019

CONTENT / PËRMBAITJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-<u>Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Total	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

1. Gjatë diskutimeve me menaxhmentin e lartë, drejtori i auditimit të brendshëm identifikoi disa çështje strategjike të biznesit që duhet të mirren parasysh gjatë përgatitjes së planit vjetor të auditimit. Cila nga të mëposhtmet nuk përfaqëson një çështje strategjike?
A. Do të implementohet një proces i buxhetimit mujor.
B. Do të fillojë një fushatë ndërkombëtare marketingu për të zhvilluar njohjen e produktit dhe gjithashtu për të përdorur departamentin e ri të marketingut me bazë korporate.
C. Do të kërkohen kandidatët e ndërmarrjeve të përbashkëta për të siguruar aftësitë prodhuese dhe ndihmuese në tregjet evropiane dhe aziatike.
D. Do të krijohet një bazë e të dhënave për burimet njerëzore për të siguruar administrim konsistent të politikave dhe për të përmirësuar ruajtjen e të dhënave.
2. Kërkesat për nivelin e personelit, arsimin dhe trajnimin si dhe hulumtimin e auditimit, duhet të përfshihen në:
A. Statutin e departamentit të auditimit të brendshëm.
B. Doracakun e politikave dhe procedurave të departamentit të auditimit të brendshëm.
C. Planin vjetor të departamentit të auditimit të brendshëm.
D. Përshkrimet e punës për pozitat e ndryshme të stafit.
3. Anëtarëve të stafit të auditimit të brendshëm duhet t'u sigurohet një mjet i duhur përmes të cilit ata mund të diskutojnë problemet dhe të marrin përditësime në lidhje me politikat e departamenteve. Forumet (mjetet) më të përshtatshme për këtë qëllim, janë:
A. Linjat jozyrtare të komunikimit të departamentit.
B. Memorandumet brenda departamentit.
C. Takimet e stafit.
D. Konferencat e vlerësimit të punonjësve.
4. Një auditor i brendshëm ka zbuluar mashtrime të mundshme të punonjësve dhe po përgatit një raport paraprak për menaxhimin. Ky raport duhet të përfshijë:
A. Një deklaratë që auditimi i brendshëm i kryer me kujdes të duhur profesional nuk mund të sigurojë siguri absolute se parregullsitë nuk kanë ndodhur.
B. Konkluzionet e auditorit nëse ekziston informacion i mjaftueshëm për të kryer një hetim.
C. Rezultatet e një testi detektor gënjeshtresh të administruar ndaj kryerësit të dyshuar të mashtrimit.
D. Një listë të testeve të propozuara të auditimit për të ndihmuar në zbulimin e ekzistencës së mashtrimeve të ngjashme në të ardhmen.
5. Një auditor i brendshëm po kryen intervistat ndaj tre punonjësve të cilët kishin qasje në një pasuri të vlefshme që është zhdukur. Gjatë kryerjes së intervistave, auditori i brendshëm duhet të:
A. Përgjigjet ndaj mos bashkëpunimit duke kërcënuar me pasoja negative për një sjelljeje të tillë.
B. Kryej intervistat në grup.
C. Mos tregojë se menaxhmenti do të heqë dorë nga ndjekja penale nëse bëhet kthimi i pasurisë.
D. Lejoj të dyshuarin të kthehet në punë pas intervistës në mënyrë që të mos ngjall dyshime.
6. Një shqetësim i një përdoruesi të një qendre shërbimesh kompjuterike është se transaksionet e një firme mund të përdoren aksidentalisht në procesin e azhurnimit të skedarëve kryesor (master) të një firme të dytë. Procedura e kontrollit që do të siguronte më së miri integritetin e skedarëve kryesor (master) gjatë proceseve të azhurnimit, është kontrolli për:
A. Plotësia e të dhënave hyrëse, të tilla si kontrolli i sekuencës kompjuterike.
B. Skedarët kryesor (master) të saktë, të tilla si një etiketë e header-it.
C. Saktësia e futjes së të dhënave, të tilla si kontrolli i raporteve të detajeve.
D. Saktësia e mirëmbajtjes së skedarëve, siç është rishikimi i raporteve të përgjashtimeve.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

7. Sipas standardeve të IIA-së lidhur me kujdesin e duhur profesional, një auditor i brendshëm duhet të:
- A. Konsideroj materialitetin relativ ose rëndësinë e çështjeve ndaj të cilave procedurat e auditimit janë aplikuar.
 - B. Theksoj përfitimet e mundshme të një auditimi pa marrë parasysh kostot.
 - C. Marr parasysh nëse janë përmbushur standardet operative të krijuara dhe jo nëse këto standarde janë të pranueshme.
 - D. Përzgjidh procedurat që kanë gjasa të sigurojnë siguri absolute që ato parregullsi nuk ekzistojnë.
8. Një menaxher prodhimi në një kompani prodhuese të mesme filloi të porosis lëndë të para të tepërta dhe i dërgonte ato në kompaninë me shumicë të cilën menaxheri po e menaxhonte si një biznes anësor. Menaxheri ka falsifikuar dokumentet e pranimit dhe ka miratuar faturat për pagesë. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit ka më shumë gjasa të zbulojë këtë mashtrim?
- A. Merrja e një mostre të pagesave; krahasimi i urdhërporosive të blerjes, raporteve të pranimit, faturat dhe dokumentet e kontrollit.
 - B. Merrja e një mostre të pagesave dhe konfirmimi me shumën e blerë, çmimin e blerjes dhe datën e dërgesës nga furnitori.
 - C. Vëzhgimi i dokumentacionit marrës dhe numërimi i materialeve të pranuara; krahasimi i numërimeve me raportet e pranuara të plotësuara nga personeli i pranimit.
 - D. Kryerja e analizave analitike, krahasimi i prodhimit, materialet e blera dhe nivelet e stokeve të lëndëve të para; hetimi i diferencave.
9. Politikat e reja të limitit të kreditit të shitjes janë zbatuar në sistemin e automatizuar të regjistrimeve të urdhërporosive shitëse për të kontrolluar arkëtueshmërinë. Këto politika parandalojnë futjen e ndonjë urdhërporosie të shitjes që do të shkaktonte që saldo e llogarive të arkëtueshme të tejkalonte shitjet mesatare për çdo periudhë dy mujore në periudhën paraprake 12 mujore. Menaxheri i departamentit të shitjeve ka përpiluar mbi një duzinë shembujsh që tregojnë zvogëlimin e shitjeve dhe futjen e vonuar të urdhërporosive të shitjeve. Menaxheri i departamentit pretendon se këta shembuj janë rezultat i drejtpërdrejtë i kufizimeve të politikës së re limitit të kreditit të shitjes. Të dhënat dhe informacioni i menaxhmentit të shitjeve sigurojnë:
- A. Reagim (feedback) ndaj të dhënave të kontrollit mbi politikën e re korporative.
 - B. Informata të parëndësishme argumentuese.
 - C. Dëshmi se politika e re e limitit të kreditit të shitjes nuk po përmbush qëllimin e korporatës për të kontrolluar arkëtueshmërinë e vëllimit të shitjeve të reja.
 - D. Një përfundim statistikisht i vlefshëm lidhur me ndikimin në emrin e mirë të klientit në lidhje me politikën e limitit të kreditit të shitjes.
10. Për të monitoruar më mirë performancën e menaxhmentit operativ, menaxhmenti ekzekutiv ka kërkuar që auditorët e brendshëm të shqyrtojnë pasqyrat financiare të ndërmjetme, të cilat janë të përgatitura vetëm për përdorim të brendshëm. Edhe pse pasqyrat financiare të ndërmjetme janë përgatitur për disa vite, kjo do të jetë hera e parë që auditorët e brendshëm janë përfshirë. Arsyeja kryesore për këtë kërkesë ishte që menaxhmenti ekzekutiv ishte i befasuar me fitimin neto më të ulët se që parashikohej në pasqyrat financiare të audituara të vitit të kaluar. Fitimet ishin manipuluar artificialisht në pasqyrat financiare tremujore. Në punën e tyre në pasqyrat financiare të ndërmjetme të këtij viti, auditorët e brendshëm ka të ngjarë të përqëndrohen në cilën nga këto?
- A. Nëse të pagueshmet janë njohur siç duhet në fund të periudhës së ndërmjetme.
 - B. Kohën e njohjes së të hyrave dhe vlerësimin e stokeve.
 - C. Nëse vlerësimet e kontabilitetit janë të arsyeshme, duke pasur parasysh rezultatet e kaluara.
 - D. Nëse ka pasur ndryshime në parimet e kontabilitetit që ndikojnë materialisht në pasqyrat financiare.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

11. Një korporatë shumëkombëshe ka një zyrë në një degë të huaj me një strukturë të transferimit monetar. Kontrolli i mirë i brendshëm kërkon që:
- A. Personi që bën transferet bankare nuk kryen harmonizimin bankar.
 - B. Menaxherja e degëve nuk bënë pagesën e pagave për punonjësit.
 - C. Normat e përkthimit në valutë të huaj llogariten ndaras nga dy punonjës të degëve në të njëjtin departament.
 - D. Punësimi i punonjësve të degës individuale miratohet nga zyra qendrore.
12. Menaxhmenti i një kompanie prodhuese ka kërkuar nga departamenti i auditimit të brendshëm të kryejë një auditim të sistemit të menaxhimit të parasë për të vlerësuar përshtatshmërinë e kontroleve ekzistuese të brendshme mbi menaxhimin e keshit dhe për të identifikuar mundësitë për të rritur kontrollin e menaxhimit dhe efikasitetin operativ. Kompania ka katër departamente prodhuese të vendosura në zona të ndryshme gjeografike. Kompania ka deleguar menaxhimin e përditshëm të parave në secilin departament operativ vendor. Paraja e tepërt investohet në programet afatshkurtra të menaxhimit të parasë së gatshme të institucioneve financiare vendase. Këto investime afatshkurtra janë burimi i vetëm i të hyrave nga interesi për departamentet operative. Secili departament ka një linjë kredie me një institucion financiar vendor por duhet të rregullojë nevojat afatgjata të financimit përmes zyrës qendrore të kompanisë.
- Gjatë kryerjes së një rishikimi të procedurave të menaxhimit të parasë në departamente për planifikimin paraprak të auditimit, auditori i brendshëm ka vënë në dukje se menaxhmenti është i shqetësuar se:
- Disa departamente kanë saldo të tepërta të parasë dhe mund të mos jenë duke investuar saldot afatshkurtra në mënyrë që të maksimizojnë kthimet në kompani.
 - Një departament ka automatizuar procesimin e arkëtive të parasë së gatshme, por nuk ka implementuar procedurat e duhura të kontrollit për të siguruar që të gjitha paratë do të regjistrohen.
 - Procedurat e menaxhimit të parasë së departamenteve mund të mos jenë në përputhje me objektivat e përgjithshme të korporatës (dmth. Mund të mos ketë koordinim të duhur midis zyrës dhe ndarjeve lidhur me menaxhimin e parasë).
- Departamenti A ka një numër të madh të klientëve të vegjël dhe bënë mbledhjen automatike të parasë. Klientëve u kërkohet të kthejnë një kopje të faturës së tyre me pagesën e tyre (dokumentin e kthimit). Dokumenti i kthimit përmban numrin e llogarisë së klientit, emrin, dhe informacionin tjetër përkatës. Një listë e parave të gatshme të pranuar krijohet menjëherë nga zyrtari i pranimit të parave të gatshme, i cili pastaj ndan çeqet dhe dokumentet e kthimit. Çeqet i jepen arkëtarit për depozitim. Dokumentet e kthimit dorëzohen në departamentin e llogarive të arkëtueshme për regjistrim. Kërkesat e klientit janë referuar në seksionin e shërbimit të klientit të departamentit të llogarive të arkëtueshme.
- Nëse një klient nuk arrin të kthejë dokumentin e kthimit, kontrolli më i mirë do të ishte që të ketë një dokument zëvendësues të përgatitur nga:
- A. Zyrtari i pranimit të parave të gatshme.
 - B. Arkëtari.
 - C. Zyrtari i llogarive të arkëtueshme.
 - D. Departamenti i shërbimit ndaj klientit.
13. Për të përcaktuar nëse rimbursimet e dhëna ndaj konsumatorëve janë miratuar siç duhet, një auditor i brendshëm duhet të gjurmojë regjistrimet e llogarive të arkëtueshme me:
- A. Faturat e shitjes.
 - B. Këshillat për remitancën.
 - C. Dokumentet e transportit.
 - D. Kredit Notat e lëshuara.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!
Nga 2 pikë secila

14. Cila saldo e llogarive të mposhtme ka më shumë gjasa të keqdeklarohet nëse moshimi i llogarive të arkëtueshme nuk kryhet?
- A. Të hyrat nga shitja.
 - B. Kthimet e shitjeve.
 - C. Llogaritë e arkëtueshme.
 - D. Shpenzimet e borxheve të këqija.
15. Kur një kompani e furnizimit nuk është në gjendje të plotësojë plotësisht një urdhërporosi, ajo i shënjon artikujt që mungojnë në depo si kthim i porosisë në urdhërporosinë e klientit dhe i regjistron këta artikuj në një dosje të kthimit të porosive që menaxhmenti mund të shikojë ose të shtypë. Konsumatorët janë duke u bërë të pakënaqur me kompaninë, sepse duket e paaftë të mbajë gjurmë dhe të dërgojë artikujt e anuluar sapo ata të jenë në dispozicion. Qasja më e mirë për sigurimin e ofrimit të shpejtë të artikujve që mungojnë në depo është që:
- A. Të harmonizohet dosja e kthimit të porosive me artikujt e shpërndarë çdo ditë.
 - B. Të rritet niveli i stokeve për të minimizuar numrin e herërave që kushtet e mbetjes pa stoke në depo ndodhin.
 - C. Të implementohet shkëmbimi elektronik i të dhënave me furnitorët për të ulur kohën për të rimbushur stoqet.
 - D. Të harmonizohet shuma e urdhërporosive të plotësuara dhe atyre të kthyer me totalin e të gjitha urdhërporosive të vendosura çdo ditë.
16. Funkzioni i pranimit të parave të gatshme duhet të ndahet nga funksioni i mbajtjes së regjistrimeve në një organizatë në mënyrë që të:
- A. Ruani fizikisht arkëtimet në para të gatshme.
 - B. Vendosni llogaridhënien kur paraja është marrë së pari.
 - C. Parandalohen pagesat nga arkëtimet në para të gatshme.
 - D. Minimizohen përvetësimet e pazbuluara të arkëtimeve të parave.
17. Menaxhmenti beson se disa komisione të shitjeve specifike për vitin ishin shumë të mëdha. Saktësia e shpenzimeve të komisioneve të regjistruara për shitësit specifikë përcaktohet më së miri nga:
- A. Llogaritja e komisioneve të shitjeve të përzgjedhura.
 - B. Llogaritja e koeficientëve të komisioneve.
 - C. Përdorimi i procedurave analitike.
 - D. Testet e arsyeshmërisë së përgjithshme.
18. Departamenteve të auditimit të brendshëm shpesh iu kërkohet që të koordinojnë punën e tyre me atë të auditorëve të jashtëm. Cila nga aktivitetet në vijim ka të ngjarë të jetë e kufizuar për auditorin e jashtëm?
- A. Vlerësimi i sistemit të kontrollit mbi grumbullimin e parave të gatshme dhe transaksioneve të ngjashme.
 - B. Deklarimi për korrektësinë e paraqitjes së pozicionit të parasë.
 - C. Vlerësimi i përshtatshmërisë së sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm të organizatës.
 - D. Rishikimi i sistemit të krijuar për të siguruar përputhjen me politikat dhe procedurat që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në operacionet.

19. Një organizatë e shitjes me pakicë sapo ka implementuar shkëmbimin elektronik të të dhënave (EDI) për të lëshuar urdhërblerja për furnitorët kryesorë. Zhvilluesi i sistemit ka zhvilluar një bazë të dhënash të furnitorëve të miratuar. Furnitorët e rinj mund të shtohen vetëm pas një rishikimi të hollësishëm nga menaxheri i blerjeve dhe drejtori i marketingut. Vetëm agjentët e blerjeve mund të lëshojnë urdhërblerja dhe shuma e urdhërbljerjeve për një linjë të caktuar produktesh nuk mund të kalojë shumën e buxhetuar të përcaktuar nga menaxheri i marketingut.

Të gjitha blerjet shkojnë në qendrën e shpërndarjes, ku skanohen elektronikisht në sistemin kompjuterik. Të gjithë artikujt hyrës duhet t'i referohen urdhërblerjes së kompanisë dhe artikujt që nuk përmbajnë një referencë të tillë nuk pranohen. Nuk përdoren fletëpranimet me numër të paracaktuar, por të gjitha faturat i referohen urdhër blerjes. Etiketat e çmimit gjenerohen sipas porosisë së blerjes dhe për sasi të shënuara në raportin e pranimi elektronik të skanuar. Numri i etiketave të krijuara të çmimeve përputhet me numrin e produkteve të marra.

Furnitori dërgon një faturë tek shitësi me pakicë. Faturat regjistrohen në sistem. Softueri kompjuterik është i programuar që të përputhe faturën e furnitorit, urdhër blerjen dhe raportin e pranimi. Nëse të tre këto dokumente përputhen brenda një tolerance prej 0.5%, programi kompjuterik i planifikon artikujt për pagesë brenda kohës për të përfituar nga zbritjet në blerje. Çeku gjenerohet nga programi i pagesave me para të gatshme dhe nënshkruhet e dërgohet me e-mail në formë elektronike. Nëse ka një mospërputhje midis të tre dokumenteve, shtypet një raport i cili i dërgohet departamenti të llogarive të pagueshme për hetim.

Cila nga deklaratat e mëposhtme, nëse është e vërtetë, do të kontribuonte në efektivitetin e kontrollit të mjedisit kompjuterik të përshkruar më lart?

- A. Kompania përdor një program të automatizuar të kontrollit të qasjes që identifikon të gjithë përdoruesit, të dhënat dhe veprimet që mund të merren nga përdoruesit.
- B. Vetëm programuesi përgjegjës për kodimin e ndryshimeve zbaton të gjitha ndryshimet e programit.
- C. Agjentët përgjegjës të blerjeve për blerjen e linjave të prodhimit të furnizuar nga furnitori duhet të iniciojnë të gjitha ndryshimet në bazën e të dhënave të furnitorit..
- D. Departamenti i pranimi nuk duhet të ketë qasje në informacionin e porosisë së blerjes.

20. Një organizatë është rritur me shpejtësi dhe ka automatizuar sistemin e saj të burimeve njerëzore. Organizata ka zhvilluar një bazë të dhënash të madhe që ndjek punonjësit, përfitimet e punonjësve, zbritjet e pagave, klasifikimet e vendeve të punës, kodin etnik, moshën, sigurimin, mbrojtjen mjekësore dhe informacione të tjera të ngjashme. Menaxhmenti ka kërkuar nga departamenti i auditimit të brendshëm të rishikojë sistemin e ri. Auditori ka rishikuar planin e përfitimeve të daljes në pension dhe ka përcaktuar se përfitimet e pensionit dhe mjekësore janë ndryshuar disa herë gjatë dhjetë viteve të fundit. Auditori dëshiron të përcaktojë nëse ka justifikim për të kryer hetime të mëtejshme të auditimit. Procedura më e përshtatshme e auditimit do të ishte të:

- A. Rishikoj trendin e shpenzimit të përgjithshëm të daljes në pension gjatë dhjetë viteve të fundit. Nëse shpenzimet e daljes në pension janë rritur, kjo do të tregonte nevojën për hetime të mëtejshme.
- B. Përdor softuerin e përgjithësuar të auditimit për të marrë një mostër të njësisë së valutës të paguar të daljes në pension dhe për të përcaktuar nëse çdo punonjës i pensionuar është paguar në mënyrë korrekte.
- C. Shqyrtojë arsyeshmërisë e pagesës së pensionit dhe shpenzimeve mjekësore për çdo person në përputhje me planin i cili ishte në fuqi kur punonjësi u pensionua.
- D. Përdor softuerin e përgjithësuar të auditimit për të marrë një mostër të veçorive të pagesës së daljes në pension dhe kryej teste të hollësishme për të përcaktuar nëse çdo person i zgjedhur ka pasur përfitimet e duhura.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

21. Një kompani shumëkombëshe ka një marrëveshje me një rrjet të vlerës së shtuar (VAN) që siguron kodimin dhe transferimin e komunikimit për këmbimin elektronik të të dhënave të kompanisë (EDI) dhe transferimin elektronik të fondeve (EFT). Para transferimit të të dhënave në rrjetin e vlerës së shtuar, kompania kryen përpunimin paraprak online të transaksioneve. Auditori i brendshëm është përgjegjës për vlerësimin e kontrolleve të përpunimit paraprak. Përveç kësaj, marrëveshja ndërmjet kompanisë dhe rrjetit të vlerës së shtuar thekson se auditorit të brendshëm i lejohet të kontrolloj dhe raportoj mbi kontrollet ekzistuese (të vendosura) në rrjetin e vlerës së shtuar në baza vjetore. Kontrata specifikon se qasja në rrjetin e vlerës së shtuar mund të ndodhë papritur, gjatë tremujorit të dytë ose të tretë të vitit fiskal të kompanisë. Kjo periudhë është zgjedhur kështu për shkak se nuk do të ndërhynte në përpunimin gjatë periudhave të transaksioneve kulmore të rrjetit të vlerës së shtuar. Kjo dispozitë nuk është shqyrtuar me auditimin e brendshëm. Plani vjetor i auditimit i miratuar nga bordi i drejtorëve specifikon se një auditim i plotë do të bëhet gjatë vitit aktual.
- Cila nga të mëposhtmet nuk do të përfshihej si arsye e kompanisë që të përdor transferimin elektronik të fondeve (EFT) me sistemin për këmbimin elektronik të të dhënave të kompanisë (EDI)?
- A. Për të përfituar nga vonesa kohore e lidhur me instrumentet e negociueshme.
 - B. Të lejoj kompaninë të negociojë zbritjet me furnitorët e EDI-të bazuar në pagesën e shpejtë.
 - C. Për të përmirësuar programin e menaxhimit të parasë.
 - D. Për të zvogëluar kohën e hyrjes dhe gabimet gjatë regjistrimit.
22. Në mjedisin informatikë të përdoruesit përfundimtar, një përdorues individual do të ishte përgjegjës për të bërë cilin nga kontrollet e mëposhtme?
- A. Standardet e pronësisë së të dhënave.
 - B. Ruajtjen e kopjes rezervë (backup) dhe rikuperimin.
 - C. Manualët teknike.
 - D. Inventarin e pajisjeve.
23. Shkrimi i një programi të auditimit ndodh në cilën fazë të procesit të auditimit?
- A. Gjatë fazës së planifikimit.
 - B. Pas testimit të kontrolleve të brendshme për të përcaktuar nëse do të mbështeten në kontrollet ose auditimin e tyre.
 - C. Gjatë kryerjes së auditimit.
 - D. Në fund të çdo auditimi, programi standard i auditimit duhet të rishikohet për auditimin e radhës për të siguruar mbulimin e zonave problematike të vërejtura.
24. Departamenti i financave i një njësie qeveritare ka një model kompjuterik për parashikimin e të ardhurave tatimore për t'u përdorur në përgatitjen e buxheteve vjetore. Ekipit të auditimit të brendshëm i është kërkuar të auditojë modelin. Një objektiv e arsyeshme e auditimit do të ishte:
- A. Verifikimi se për vlerat hyrëse të ndryshme, modeli jep rezultate në përputhje me sjelljen e të ardhurave.
 - B. Konfirmimi që modeli parashikon çdo lloj të ardhurash brenda një përqindje të vogël të të ardhurave aktuale.
 - C. Përcaktimi nëse programet e përdorura për parashikimin e këtij viti ishin identike me ato të përdorura në vitin paraprak.
 - D. Sigurimi që modeli është modifikuar në mënyrë që të parashikojë të ardhurat aktuale të vitit të kaluar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

25. Gjatë auditimit kryhen shumë detyra administrative të auditimit. Detyra të ndryshme të auditimit janë paraqitur më poshtë dhe iu është dhënë një numër. Në përgjigjet, numrat e detyrave janë të grupuara si të kryera kryesisht nga një auditor, menaxher i auditimit ose drejtori i auditimit. Vetëm një nga grupimet e mëposhtme është e saktë. Zgjidh përgjigjen në të cilën detyrat e listuara janë grupuar më së miri sipas pozicionit dhe kryerjes së detyrave.

- I. Zgjedhja e të audituarit dhe fushëveprimi i auditimit është caktuar.
- II. Një intervistë fillestare është zhvilluar me të audituarin ku i është shpjeguar fushëveprimi i auditimit.
- III. Janë përgatitur letrat e punës që tregojnë punën e kryer të auditimit.
- IV. Puna e auditimit është mbikëqyrur gjatë punës në terren.
- V. Janë rishikuar letrat e punës.
- VI. I është kërkuar menaxhmentit të të audituarit të shpjegoj gjetjet e pazakonta.
- VII. Letrat e punës janë finalizuar dhe është përgatitur një raport paraprak.
- VIII. Rishikimi i raportit të auditimit para diskutimit me menaxhmentin.
- IX. Pasi që raporti i auditimit është diskutuar me menaxhmentin e të audituarit, raporti dhe letrat e punës kanë pasur një rishikim përfundimtar para se të nënshkruhet, publikohet dhe shpërndalet raporti i auditimit.

Jo të gjitha detyrat janë të listuara në secilën përgjigje dhe disa nga detyrat e numëruara mund të bëhen nga më shumë se njëri prej personave të listuar më sipër.

- A. Auditori (3, 6, 7). Menaxher i auditimit (2, 5, 8). Drejtor i Auditimit (1, 8, 9).
- B. Auditori (2, 4, 7). Menaxher i auditimit (3, 4, 8). Drejtor i Auditimit (1, 6, 9).
- C. Auditori (3, 7, 9). Menaxher i auditimit (2, 4, 6). Drejtor i Auditimit (2, 3, 8).
- D. Auditori (2, 7, 9). Menaxher i auditimit (4, 6, 8). Drejtor i Auditimit (1, 5, 6).

26. Një kompani prodhuese po zgjerohet me shpejtësi dhe po konsideron shtimin e një linje të re prodhimi. Punonjësit aktualisht po punojnë me ndërrime të dyfishta dhe janë duke marr shumë të mëdha të pagës jashtë orarit. Kërkesa për të gjitha produktet e kompanisë është aktualisht e lartë, por menaxhmenti është i shqetësuar për luhatjet e kërkesës me ndryshimet në ekonomi dhe zhvillimet teknologjike të konkurrentëve. Menaxhmenti është i shqetësuar me çështje të tilla si nëse ai është duke përdorur në mënyrë efikase burimet e veta, nëse po zgjerohet shumë shpejt ose jo me shpejtësinë e duhur, nëse morali i punonjësve po zvogëlohet dhe nëse zgjerimi i ardhshëm duhet të financohet brenda ose nëpërmjet borxhit.

Menaxhmenti është i shqetësuar se produktiviteti dhe morali i punonjësve mund të jenë në rënie edhe pse punonjësit e prodhimit po paguhet më shumë me paga jashtë orarit. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të ishte më pak efektive në trajtimin e këtij shqetësimi?

- A. Zhvilloni një plan të pagës së punonjësve dhe analizoni ndryshimet në pagën jashtë orarit.
- B. Zhvilloni një plan të prodhimit për punonjës gjatë dy viteve të fundit të shtresëzuar nga prodhimi gjatë orarit standard të punës dhe prodhimit gjatë periudhave të jashtë orarit.
- C. Merrni një mostër statistikore të të punësuarve dhe intervistoni punonjësit e zgjedhur lidhur me moralin e tyre, produktivitetin dhe pikëpamjet mbi metodat për të përmirësuar efikasitetin.
- D. Merrni të dhënat e prodhimit lidhur me "praktikat më të mira" nga një industri e krahasueshme dhe identifikoni fushat e dallimeve. Rishikoni këto duke intervistuar mbikëqyrësve të prodhimit.

27. Për auditorin e brendshëm, dokumentet (letrat) e punës shërbejnë për qëllimet e mëposhtme:

- A. Ofrojnë për të audituarin një vend për të bërë përgjigje ndaj rekomandimeve të auditimit.
- B. Bëjnë që raporti i auditimit të jetë më i lexueshëm, duke siguruar një vend për t'i bashkuar eksponentet.
- C. Ofrojnë mbështetjen kryesore për raportin e auditorit të brendshëm.
- D. Ofrojnë një vend për të përmbledhur rekomandimet e përgjithshme të auditimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

28. Një auditor i brendshëm është caktuar për të kryer një auditim të programit të sigurimeve të kompanisë, duke përfshirë përshtatshmërinë e qasjes për të minimizuar rreziqet ndaj kompanisë. Kompania siguron vetveten ndaj humbjeve të mëdha të viktimave dhe ofron përfitime shëndetësore për të gjithë punonjësit e saj. Kompania është një firmë e madhe kombëtare me mbi 15,000 punonjës të vendosur në pjesë të ndryshme të vendit. Ajo përdor një procesor të jashtëm të kërkesave për të administruar programin e sa të kujdesit shëndetësor. Shpenzimet mjekësore të kompanisë janë rritur me afërsisht 8% në vit për pesë vitet e fundit dhe menaxhmenti është i shqetësuar lidhur me kontrollin e tyre.

Kur ishte caktuar auditimi, menaxhmenti kërkoi nga auditori që të vlerësonte përshtatshmërinë e përdorimit të vetë-sigurimit për të minimizuar rrezikun ndaj organizatës. Duke pasur parasysh qëllimin e auditimit të kërkuar nga menaxhmenti, a duhet që auditori të angazhojë një konsulent aktuarial (ekspert i sigurimeve) për të ndihmuar në auditimin nëse këto aftësi nuk ekzistojnë në personel?

- A. Jo. Departamenti i auditimit është i aftë në vlerësimin e kontroleve dhe konceptet e kontrollit të sigurimit nuk dallohen nga konceptet e tjera të kontrollit.
- B. Jo. Është një funksion normal i auditimit për të vlerësuar rrezikun; prandaj, ky angazhim i auditimit nuk është unik.
- C. Po. Aktuari (eksperti i sigurimeve) është thelbësor për të përcaktuar nëse shpenzimet e kujdesit shëndetësor janë të arsyeshme.
- D. Po. Aktuari (eksperti i sigurimeve) ka aftësi që zakonisht nuk gjenden tek auditorët për të identifikuar dhe matur rreziqet e vetë-sigurimit.

29. Auditorët përdorin një shumëllojshmëri të metodave të indeksimit dhe referimit në dokumentet e punës së tyre të auditimit. Një menaxher i auditimit të brendshëm mund të krijojë një metodë të indeksimit të letrës së punës të përshtatuar për nevojat e një organizate specifike. Një agjenci qeveritare e auditimit do të krijonte një metodë për të gjitha organizatat nën juridiksionin e agjencisë. Cila nga të mëposhtmet më së miri shpjegon arsyen e këtij ndryshimi midis dy metodave të indeksimit të letrës së punës?

- A. Menaxheri i auditimit të brendshëm krijon një metodë që thjeshton procesin e rishikimit brenda një organizate të caktuar, por agjencia qeveritare e auditimit krijon një metodë uniforme për të thjeshtuar procesin e rishikimit të organizatave shumë të ndryshme që do të auditohen.
- B. Metoda e menaxherit të auditimit të brendshëm përcaktohet nga Standardet e Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA), por metoda e agjencisë qeveritare të auditimit kërkohet me politika të agjencisë.
- C. Metoda e menaxherit të auditimit të brendshëm përcaktohet nga Standardet e IIA, por me ligj kërkohet metoda e agjencisë qeveritare të auditimit.
- D. Menaxheri i auditimit të brendshëm krijon një metodë të përcaktuar nga komiteti i auditimit të organizatës, por agjencia qeveritare e auditimit krijon një metodë uniforme që kërkohet me ligj..

30. Një dokument pune është i plotë kur:

- A. Përputhet me kërkesat e formatit të departamentit të auditimit.
- B. Përmban të gjitha elementet e gjetjes.
- C. Është i qartë, konciz dhe i saktë.
- D. Plotëson objektivin e auditimit për të cilin është zhvilluar.

31. Qëllimi kryesor i dokumenteve të punës të një auditori është:

- A. Ofrimi i dëshmive për planifikimin dhe ekzekutimin e procedurave të auditimit të kryera.
- B. Të shërbejnë si një mjet me të cilin përgatiten pasqyrat financiare.
- C. Të dokumentojnë mungesat në strukturën e kontrollit të brendshëm me rekomandime për përmirësim për menaxhmentin.
- D. Pajtimi me standardet e auditimit të profesionit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

32. Departamenti i auditimit të brendshëm të një institucioni të madh financiar përfundoi një auditim të operacioneve tregtare të derivateve të kompanisë në degën e saj jashtë vendit. Raporti i auditimit ishte kritik sa i përket mungesës së kontrolleve në procesin e tregtimit dhe mungesës së monitorimit efektiv të tregtarëve të suksesshëm nga zyrja vendore. Auditori dyshoi, por nuk e potencoi, se arsyeja që zyrja vendore i toleronte sjelljet e njësisë tregtare të degës së huaj ishte se dega dhe në veçanti një tregtar individual, kishte qenë shumë i suksesshëm. Suksesi krijoi fitime të mëdha dhe kështu ndikoi në shpërblimet e të gjithë anëtarëve të menaxhmentit të lartë. Pas pranimit të raportit të auditimit, menaxhmenti i lartë tregoi se ishte duke ndërmarrë veprime korrigjuese. Bazuar në veprimin e menjëhershëm korrigjues, auditori nuk ka raportuar gjetjen në komitetin e auditimit.

Cila nga deklaratat e mëposhtme është (janë) të sakta në lidhje me sistemin e kompensimit dhe bonuseve përkatëse të kompanisë?

- I. Sistemi i bonusit duhet të konsiderohet pjesë e mjedisit të kontrollit të organizatës dhe duhet të merret parasysh në formulimin e një raporti mbi kontrollin e brendshëm.
 - II. Sistemet e kompensimit nuk janë pjesë e sistemit të kontrollit të një organizate dhe nuk duhet të raportohen si pjesë e sistemit të kontrollit të një organizate.
 - III. Auditimi i sistemit të kompensimit duhet të kryhet në mënyrë të pavarur nga një auditim i sistemit të kontrollit mbi aktivitetet tregtare të derivateve të kompanisë dhe nuk duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e auditimit të derivatëve.
- A. Vetëm I.
B. Vetëm II.
C. Vetëm III.
D. II dhe III.

33. Sipas Standardeve të IIA-së, gjetjet e raportuara të auditimit janë rezultat i procesit të krahasimit të asaj që është aktualisht me atë që duhet ose parashikohet të jetë. Gjatë përcaktimit të asaj që duhet të jetë, gjatë një kontrolli të funksionit të thesarit të një kompanie, cili nga kriteret e mëposhtme kundrejt të cilave do të duhet të gjykohen veprimtaritë (operacionet) aktuale, është më pak i dëshirueshmi?

- A. Operacionet e funksionit të thesarit, siç janë dokumentuar gjatë auditimit të fundit.
- B. Politikat dhe procedurat e kompanisë të cilat delegojnë autoritetin dhe caktojnë përgjegjësitë.
- C. Ilustrimet e teksteve për financa të cilat tregojnë se cilat janë praktikat e gjithë – pranuar si të mira për sa i takon funksioneve të thesarit.
- D. Kodifikimi i praktikave më të mira të funksionit të thesarit në industrinë përkatëse.

34. Cila nga elementët e mëposhtëm është një element i duhur në pjesën e rezultateve të raportit të auditimit?

- A. Statusi i gjetjeve nga raportet paraprake.
- B. Personeli i përdorur.
- C. Rëndësia e mangësive.
- D. Plani i angazhimit.

35. Një auditor ka dorëzuar draftin e parë të raportit të auditimit tek i audituari në përgatitje për një intervistë dalëse. Më poshtë është një ekstrakt nga ky raport:

Auditimi u krye për të arritur disa objektiva.

Për të verifikuar ekzistencën e makinerisë së përdorur që është duke u ruajtur në depo.

Për të përcaktuar nëse makineria është dëmtuar gjatë ruajtjes në depo.

Për të rishikuar procedurat e trajtimit që kryhen nga personeli i depos.

Për të përcaktuar nëse procedurat e duhura të kontabilitetit janë duke u ndjekur për makineritë që po mbahen në depo.

Për të kalkuluar vlerën e drejtë të tregut, aktuale, për stoqet e makinave në depo.

Për të krahasuar vlerën totale të makinerisë me regjistrimet kontabël të kompanisë.

Është konfirmuar se nga 30 makinat e përzgjedhura për mostrën nga regjistrat e blerjes, 13 ishin të pranishme në katin e depos dhe 5 të tjerat ishin në bankën e ngarkesës gati për t'u transportuar në fabrikën e prodhimit. Kohë më parë, dymbëdhjetë të tjerët ishin dërguar në fabrikën e prodhimit. Një ekzaminim i procedurave të kontabilitetit të përdorura për depo zbuloi dështimin nga nëpunësi i kontabilitetit të depos për të harmonizuar regjistrimet mujore të stokeve të makinave, ashtu siç kërkohet nga politikat e kompanisë. Një mostër prej 25 makinash u ekzaminua për dëmet e mundshme dhe të gjitha, përveç njëres, ishin në gjendje të mirë. Është konfirmuar nga auditorët se procedurat e trajtimit të përshkruara në manualin e politikës së depos duket të jenë adekuate dhe se personeli i depos me sa duket po i ndjek këto procedura, me përjashtim të ekzaminimit të aartikujve që janë marrë për inventarizim.

Gjatë komunikimit me të audituarin, ekzistojnë në që të dyja, faktorët e situatës dhe karakteristikat e mesazhit që mund të dëmtojnë procesin e komunikimit. Auditori ka vetëm kontroll të kufizuar mbi faktorët e situatës, por ka kontroll të dukshëm mbi karakteristikat e mesazhit. Elementët e mëposhtëm zakonisht përfshihen në raportet përfundimtare të auditimit: qëllimi, fushëveprimi, rezultatet, konkluzionet dhe rekomandimet.

Cila nga të mëposhtmet do të duket që është karakteristikë e një mesazhi që auditori që ka përgatitur raportin e mësipërm e ka neglizhuar?

- A. Sekuenca e mesazhit.
- B. Natyra e audiencës.
- C. Zhurma.
- D. Takimet paraprake me të audituarin.

36. Pasi që raporti i auditimit me gjetje të pafavorshme i është komunikuar personelit të duhur të të audituarit, veprimi i duhur është të:

- A. Planifikojë një rishikim pasues.
- B. Implementojë veprime korigjuese të sugjeruara nga gjetjet.
- C. Shqyrtojë më tej të dhënat që mbështesin gjetjet.
- D. Mbledh të dhëna të reja për të mbështetur gjetjet.

37. Departamenti i auditimit të brendshëm për një zinxhir të dyqaneve me pakicë kohët e fundit përfundoi një auditim të rregullimeve të shitjeve në të gjitha dyqanet në rajonin juglindor. Auditimi zbuloi se disa dyqane i kushtojnë kompanisë rreth 85,000€ për tremujor me borxhe të dyfishta për llogaritë e klientëve.

Raporti i auditimit, i publikuar tetë javë pas përfundimit të auditimit, përfshinte rekomandimet e auditorëve të brendshëm për menaxherët e dyqaneve që duhet të parandalojë borxhet e dyfishta për llogaritë e klientëve. Cila nga standardet e mëposhtme për raportim nuk është marrë parasysh në rastin e mësipërm?

- A. Veprimet përcjellëse nuk ishin adekuate.
- B. Auditorët duhet të kishin implementuar veprime korigjuese të përshtatshme sapo që janë zbuluar borxhet e dyfishta.
- C. Rekomandimet e auditorit nuk duhet të përfshihen në raport.
- D. Raporti nuk ishte në kohë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

38. Të dhënat e mëposhtme u mblodhën gjatë një hetimi nga auditori i brendshëm për shkak të rritjes materiale të shpenzimeve të borxheve të këqija. Në përgatitjen e një raporti të gjetjeve, secila nga çështjet mund të klasifikohet si “kriter”, “shkak”, “gjendje”, “efekt” ose “informacioni i sfondit”.

- I. Porositë shumë të mëdha kërkojnë miratimin e limitit të kredisë nga menaxhmenti.
- II. Testet e auditimit treguan se personeli i shitjes rregullisht nuk i merr parasysht udhëzuesit e limitit të kredisë kur merret me klientët aktual.
- III. Raporti mujor i shpenzimeve të shlyera (fshira) përgatitet, por shpërndahet vetëm tek departamenti i kontabilitetit.
- IV. Raportet e limitit të kredive përdoren vetëm në llogari të reja.
- V. Të dhënat e departamentit të kontabilitetit sugjerojnë që llogaritë e pa arkëtueshme mund të rriten me 5% për vitin aktual.
- VI. Humbja nga borxhet e këqija u rrit me 100,000€ gjatë vitit të fundit fiskal.
- VII. Edhe pse procedurat dhe kriteret janë ndryshuar për të zvogëluar sasinë e shlyerjes së borxheve të këqija, humbja e komisioneve për shkak të llogarive të shlyera është rritur për disa shitës të personelit.
- VIII. Politika e departamentit të limitit të kreditit kërkon shqyrtimin e referencave të limitit të kredisë për të gjitha llogaritë e reja.
- IX. Të dhënat e pagesave aktuale duhet të rishikohen përpara se të zgjatet limiti i kredisë për llogaritë e hapura.
- X. Për të ulur kostot, përdorimi i raporteve të jashtme të limitit të kreditit u pezullua në disa raste.
- XI. Megjithatë disa pozita të stafit në departamentin e limitit të kreditit u eliminuan për të zvogëluar shpenzimet, disa llogari të reja kanë pësuar vetëm një shqyrtim të përsheptuar.
- XII. Sipas menaxherit të ri të limitit të kreditit, nuk është e nevojshme që të respektohen rreptësisht politikat e krijuara të limitit të kredisë.

“Gjendja” ilustron më së miri nga çështjet me numër:

- A. 5, 6, dhe 7.
- B. 1, 8, dhe 9.
- C. 2, 10, dhe 11.**
- D. 3, 4, dhe 12.

39. Një ekstrakt nga një gjetje e auditimit tregon se avancet e udhëtimit tejkaluan shumat maksimale të parashikuara. Politika e kompanisë siguron fonde udhëtimi për punonjësit e autorizuar për udhëtime. Avancet nuk duhet të tejkalojnë 45 ditë të shpenzimeve të parashikuara. Procedurat e kompanisë nuk kërkojnë justifikime për avancet e mëdha të udhëtimit. Punonjësit mund dhe e bëjnë akumulimin e avanceve të mëdha dhe të panevojshme.

Në gjetjen e mësipërm të auditimit, elementi i gjetjes së auditimit i njohur si gjendje është:

- A. Avancet nuk duhet të tejkalojnë shpenzimet e llogaritura për 45 ditë.
- B. Punonjësit grumbullojnë avance të mëdha të panevojshme.
- C. Procedurat nuk kërkojnë justifikim për avance të mëdha.
- D. Avancet e udhëtimit tejkaluan shumat maksimale të përshkruara.**

40. Cila nga aktivitetet e mëposhtme nuk përfshihet në përcaktimin e planit të auditimit?

- A. Zhvillimi i programeve të auditimit.**
- B. Vlerësimi i faktorëve të rrezikut.
- C. Planifikimi i kërkesave të ngarkesës së punës.
- D. Identifikimi i lokacioneve të të audituarit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

41. Një gjetje e auditimit është formuluar si në vijim:

Buxheti kapital përfshin fonde për blerjen e 11 automjeteve të reja. Shqyrtimi i të dhënave të përdorimit tregoi se: 10 automjete në flotën e 70 automjeteve janë ngasur më pak se 4,000 kilometra gjatë vitit të kaluar. Automjetet iu janë caktuar grupeve të ndryshme, normat e përdorimit të të cilëve kanë ndryshuar shumë. Nuk kishte asnjë politikë që kërkon rotacionin e automjeteve midis grupeve të përdorimit të lartë dhe të ulët. Mungesa e kriterëve për caktimin e automjeteve si dhe mungesa e një sistemi për monitorimin e përdorimit të tyre mund të çojë në blerjen e automjeteve të panevojshme.

Bazuar në faktet e paraqitura në këtë gjetje, do të ishte e pështatshme që të rekomandojmë që menaxhementi duhet të:

- A. Vendosë një minimum prej 4,000 kilometrave për tremujor si kriter për caktimin e automjeteve tek grupet e përdoruesve.
- B. Krijoj një sistem për qarkullimin e automjeteve midis përdoruesve në mënyrë periodike.
- C. Vonoj blerjen e automjeteve të propozuara derisa kapaciteti i tepërt i dukshëm të shpjegohet ose zhvlerësohet në mënyrë adekuate.
- D. Ndaloj miratimin e buxhetit kapital derisa projektet e tjera të mund të rishikohen nga auditimi i brendshëm.

42. Ju jeni përzgjedhur për të zhvilluar një departament të auditimit të brendshëm për kompaninë tuaj. Qasja juaj ka shumë të ngjarë që do të punësojë:

- A. Auditorë të brendshëm, ku secili prej të cilëve posedon të gjitha aftësitë e nevojshme për të trajtuar të gjitha detyrat e auditimit.
- B. Personel të papërvojë dhe pastaj trajnimi i tyre në mënyrën se si kompania dëshiron që ata të trajnohen.
- C. Kontabilistë të Çertifikuar pasi që shumica e punëve të auditimit janë të lidhura me kontabilitetin.
- D. Auditorë të brendshëm të cilët së bashku kanë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për të kryer të gjitha detyrat e auditimit të brendshëm.

43. Pse organizatat duhet që të kërkojnë përgjigje të menjëhershme nga të audituarit dhe të përshkruajnë veprimet korrigjues që janë implementuar në lidhje me mangësitë e raportuara?

- A. Për të hequr çështjet nga lista në pritje sa më shpejt të jetë e mundur.
- B. Në mënyrë që pajtueshmëritë të vendosen sa më shpejt që të jetë e mundur.
- C. Për të treguar pajtueshmëritë me gjetjet e auditimit.
- D. Për të siguruar që plani i auditimit është përditësuar.

44. Gjatë pjesëmarrjes në një ngjarje shoqërore, një auditor i brendshëm i përshkroi një grupi shokësh elementet e një auditimi të ndjeshëm në të cilin ai po punonte. Mënyra më e mirë nga Drejtori i Auditimit të Brendshëm për t'u marr me këtë çështje është që të:

- A. Pushojë nga puna auditorin për të vendosur një shembull për auditorët e tjerë.
- B. Largojë auditorin nga të gjitha auditimet në atë zonë ose në zona të tjera të ndjeshme.
- C. Qortojë auditorin që ka folur në ngjarjen shoqërore.
- D. Shpjegojë se ky akt është një shkelje etike e profesionit dhe se veprimi i tillë i mëtejshëm mund të rezultojë në shkarkim ose në efekte të tjera të rënda.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

45. Pas përfundimit të pjesërishëm të një rishikimi të kontrollit të brendshëm të departamentit të llogarive të pagueshme, auditori dyshon se ka ndodhur një lloj mashtrimi. Për të konstatuar nëse mashtrimi është i pranishëm, qasja më e mirë e marrjes së mostrave do të ishte përdorimi i:

- A. Mostrave thjesht të rastësishme për të zgjedhur një mostër të dëftesave të përpunuara nga departamenti gjatë vitit të kaluar.
- B. Mostrave probabiliteti-proporcional-me madhësinë për të zgjedhur një mostër të dëftesave të përpunuara nga departamenti gjatë vitit të kaluar.
- C. Mostrave të zbulimit për të zgjedhur një mostër të dëftesave të përpunuara nga departamenti gjatë vitit të kaluar.
- D. Mostrave gjykuese për të përzgjedhur një mostër dëftesash të përpunuara nga nëpunësit e identifikuar nga menaxheri i departamentit që kanë vepruar në mënyrë të dyshimtë.

46. Gjatë auditimit të departamentit të përpunimit të kërkesave të sigurimeve shëndetësore, një mostër merret për të testuar prezencën e të paguarve fiktiv edhe pse asnjë nuk dyshohet. Plani më i përshtatshëm i mostrave do të ishte:

- A. Mostrat e veçorive.
- B. Mostrat e zbulimit.
- C. Mostrat e ndryshoreve.
- D. Mostrat për ndalimin dhe shkarkimin.

47. Shumica e evidencave të paraqitura në një rast të krimit kompjuterik janë:

- A. Evidenca ligjore.
- B. Evidenca të dokumentuara.
- C. Evidenca sekondare.
- D. Evidenca të lejueshme.

48. Koncepti i pranueshmërisë së evidencave nuk përfshin cilën nga të mëposhtmet?

- A. Rëndësinë.
- B. Kompetencën.
- C. Materialitetin.
- D. Mjaftueshmërinë.

49. Dëshmia më objektive dhe relevante në një mjedis kompjuterik që përfshin mashtrimin është:

- A. Ekzaminimi fizik.
- B. Vëzhgimi fizik.
- C. Hetimet e njerëzve.
- D. Shkrimet kompjuterike.

50. Mashtrimi kompjuterik dekurajohet nga:

- A. Gatishmëria për t'e ndjekur penalisht.
- B. Zhurmuesit e izoluar.
- C. Joefikasiteti në sistemin gjyqësor.
- D. Pranimi i mungesës së integritetit në sistem.